

PLANI RREGULLUES URBAN SHTIME

Bartës i projektit



KOMUNA SHTIME

Drejtoria i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

HARTUES I PROJEKTIT



IMPACT Sh.p.k, SHTIME

PËRMBAJTJA

A. HYRJE.....	7
B. ZGJIDHJA URBANE.....	8
1. SYNIMET DHE VIZIONI.....	9
2. KONCEPTI THEMELOR	10
3. BILANCET DHE DESTINIMET E SIPERFAQEVE SIPAS BLOQJEVE URBANE.....	11
4. NDARJA NË ZONA DHE KARAKTERISTIKAT E TYRE	11
5. KARAKTERISTIKAT E ZONAVE URBANE.....	13
6. ZONAT SIPAS DESTINIMEVE TË ZGJEDHJES URBANE	18
7. TRAFIKU DHE TRANSPORTI	18
8. NDRIQIMI	23
9. GJELBËRIMI.....	24
10. INTERVENIMET DHE RINOVIMET	24
11. REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME	25
12. PARCELA NDËRTIMORE DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PARCELIMIT	25
13. TREGUESIT E PËRGJITHSHËM TË NDËRTIMIT SIPAS ZONAVE	26
• Zona urbane A.....	26
Blloku A1.....	26
o Blloku A2.....	28
o Blloku A3.....	30
o Blloku A4.....	32
o Blloku A5.....	34
• Zona urbane B	37
o Blloku B1.....	37
o Blloku B2.....	39
o Blloku B3.....	41
o Blloku B4.....	43

• Zona urbane C.....	46
o Blloku C1.....	46
o Blloku C2.....	48
o Blloku C3.....	50
o Blloku C4.....	52
o Blloku C5.....	54
o Blloku C6.....	56
o Blloku C7.....	58
 • Zona urbane D	62
o Blloku D1.....	62
o Blloku D2.....	64
o Blloku D3.....	66
o Blloku D4.....	68
o Blloku D5.....	70
o Blloku D6.....	72
o Blloku D7.....	74
o Blloku D8.....	76
 • Zona urbane E.....	79
o Blloku E1.....	79
o Blloku E2.....	81
o Blloku E3.....	83
o Blloku E4.....	85
o Blloku E5.....	87
o Blloku E6.....	89
 • Zona urbane F.....	92
o Blloku F.....	92
 • Zona urbane G	95
o Blloku G1	95
o Blloku G2.....	97
o Blloku G3.....	99
 • Zona urbane H	102
o Blloku H1.....	102
o Blloku H2.....	104
o Blloku H3.....	106
o Blloku H4.....	108

• Zona urbane I.....	111
o Blloku I1.....	111
o Blloku I2.....	113
o Blloku I3.....	115
o Blloku I4.....	117
o Blloku I5.....	119
o Blloku I6.....	121
o Blloku I7.....	123
o Blloku I8.....	125
• Zona urbane J.....	128
o Blloku J1.....	128
o Blloku J2.....	130
o Blloku J3.....	132
• Zona urbane K.....	135
o Blloku K1.....	135
o Blloku K2.....	137
o Blloku K3.....	139
• Zona urbane L.....	142
o Blloku L1.....	142
o Blloku L2.....	144
• Zona urbane M.....	147
o Blloku M1.....	147
o Blloku M2.....	149
o Blloku M3.....	151
o Blloku M4.....	153
o Blloku M5.....	155
o Blloku M6.....	157
o Blloku M7.....	159
o Blloku M8.....	161
• Zona urbane N.....	164
o Blloku N1.....	164
o Blloku N2.....	166
• Zona urbane O.....	169
o Blloku O1.....	169

o Blloku O2.....	171
o Blloku O3.....	173
o Blloku O4.....	175
o Blloku O5.....	177
o Blloku O6.....	179
• Zona urbane P.....	182
o Blloku P1.....	182
o Blloku P2.....	184
o Blloku P3.....	186
o Blloku P4.....	188
o Blloku P5.....	190
o Blloku P6.....	192
o Blloku P7.....	194
o Blloku P8.....	196
o Blloku P9.....	198
• Zona urbane Q.....	201
• Zona urbane R.....	204
o Blloku R1.....	204
o Blloku R2.....	206
o Blloku R3.....	208
• Zona urbane S.....	211
o Blloku S1.....	211
o Blloku S2.....	213
• Zona urbane T.....	216
• Zona urbane U.....	219
• Zona urbane V.....	222
o Blloku V1.....	222
o Blloku V2.....	224
 HARTAT	 227

HYRJE

Hapësira urbane e qytetit të Shtimes ka një formë të çrregullt, të përkufizuar me rrugë mjaft të qarkulluara. Kjo hapësirë urbane shtrihet në mes rrugëve magjistrale Prishtine - Prizren dhe Ferizaj – Prizren.

Hapësira urbane e qytetit të Shtimes mbulon një sipërfaqe bruto prej :
S=1531.00 ha

Konfiguracioni i hapësirës urbane është kryesisht i rrafshët në qendër, duke u pjerrtesuar në drejtim të jugut dhe perëndimit. Vlerë dhe theks të veçantë të kësaj hapësire urbane paraqesin sipërfaqet e konsiderueshme të lira dhe të gjelbëruara.

Periudha e pas luftës (pas vitit 1999) këtë hapësirë e karakterizon me ndërtime të plota , ndërtime të pjesshme pa leje si dhe degradim të objekteve dhe hapësirave të përbashkëta.

Në periudhën e kaluar kohore, për këtë hapësirë, janë hartuar disa projekte, me qëllim të ngritjes së nivelit të banimit, punës, rekreacionit, etj. Në funksion të kësaj është bërë edhe hartimi i Planit Zhvillimor Urban(PZHU) dhe Planit Zhvillimor Komunal(PZHK).

Duke qenë pjesë urbane dhe si qendër e të gjitha aktiviteteve të qytetit, deri diku në këto hapësira është përcjellur dhe ruajtur një infrastrukturë e mirë në të cilën tani, me këtë plan mund të intervenohet me lehtësi si dhe të rregullohet infrastruktura .

ZGJIDHJA URBANE

1. SYNIMET DHE VIZIONI

Bazë për hartimin e Planit Rregullues është PZHU dhe PZHK i Shtimes. Sipas këtij plani kjo zonë është trajtuar si zonë me përmbajtje mikse urbane: afarizëm, banim kolektiv, arsim, kulture, rekreacion dhe hapësira të gjelbëruara. Planit Urban Rregullues parashikon zhvillimin e një infrastrukture të re, siç janë edhe rrugët. Në disa raste këto parashikime do të dëmtojnë ndërtesat ekzistuese. Se si do të implementohen këto objektiva dhe në cilat periudha kohore, duhet të vendoset në kuadër të kornizës së strategjisë së implementimit. Strategjia e tillë implementuese duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me banorët e zonave specifike në mënyrë që të mundësohet zbatimi adekuat i Planit nga i cili do të përfitojnë të gjithë.

Planit Urban Regullativ po ashtu parashikon zgjerimin e disa rrugëve në zonat më parë të ndërtuara. Ky do të jetë një objektiv afat-gjatë dhe do të arrihet përbrenda planifikimit të kërkuar.

Me Planin Rregullues synohet të arrihet:

- I. Sigurimi dhe destinimi i sipërfaqeve për përmbushjen e nevojave të banorëve të kësaj zone hapësinore
- II. Mundësia e ndërtimit me koncesion – banim kolektiv dhe afarizëm me interes të pronarëve dhe investitorëve në funksion të zonës urbane
- III. Sigurimi i infrastrukturës së re teknike komunale: ujësjellësi, kanalizimi, instalimet elektrike, ngrohja qendrore, gazifikimi, rrjeti i internetit, sistemi i rrjetit kablovik, telefonia, etj.
- IV. Integrimi i objekteve të reja të banimit atyre publike, sociale etj. në kuadër të hapësirës urbane
- V. Ngritja e nivelit të kushteve dhe mundësive për banim, punë, argëtim, rekreacion, gjelbërim etj.
- VI. Eliminimi i pikave ndotëse dhe krijimi i mundësive për jetë të shëndoshë në ambiente të pastërta dhe të shëndosha
- VII. Mbrojtja e gjelbërimit ekzistues dhe shfrytëzimi i hapësirave gjelbëruese për rekreacion, argëtim dhe pushim.
- VIII. Mundësia e shkarkimit të komunikacionit në hapësirën urbane ngritjen e shkallës së sigurisë.
- IX. Për persona me aftësi të kufizuara, pleq, fëmijë
- X. Qasje e lehtë në infrastrukturë komunale

Vizioni i Planit Rregullues urban:

- Të jetë i implementueshëm
- Të ketë vazhdimësi urbane me forma gjeometrike
- Të krijojë një ambient aktiv
- Të jetë qendër e të gjitha tangentimeve .
- Të ketë përmbajtje reprezentative
- Të ketë koncept bashkëkohor
- Te ketë vlerë të arsyeshme në investime dhe mbi te gjitha
- Te ju shërbej qytetareve ne mënyrën me te mire te mundshme.

1. KONCEPTI THEMELOR I ORGANIZIMIT DHE RREGULLIMIT TË TERRITORIT

Koncepti themelor i planit

Koncepti themelor i planit bazohet në drejtimet e Planit Zhvillimor të Shtimes i cili këtë zonë e ka identifikuar si koncept të ri urbanistik dhe zonë mikse urbane për: Biznes, banim te dendur, institucione kulturore, sportive dhe hapësira të gjelbëruara. Në kuadër të kufijve të kësaj zone përveç objekteve ekzistuese që nuk kanë vlera materiale e të cilat parashihet të rrënohen me këtë plan, ekzistojnë edhe tërësi dhe objekte të veçanta të cilat kanë vlera arkitektonike, urbanistike dhe si të tilla janë funksionale dhe duhet të ruhen dhe inkorporohen në këtë plan.

Sipas Planit Rregullues territori organizohet në:

1. Tërësi urbane
2. Blloqe urbane dhe
3. Parcela brenda bllokut

Tërësia urbane ndahet në blloqe të cilat do te trajtohen veç e veç. Pastaj këto blloqe do të ndahen në parcela urbanistike të cilat mundësisht duhet të bashkohen sa më shumë për të krijuar kushtet e zhvillimit urb-arkitektonik të bllokut.

BILANCET DHE DESTINIMET E SIPERFAQEVE SIPAS BLLOQEVE URBANE

Bilancet e sipërfaqeve me këtë Plan Rregullues janë dhënë në formë tabelore të ndara sipas llogarive dhe strukturave në bazë të planifikimit të tërësisë urbane.

Niveli i parë – Bilanci në nivel të zonës sipas Planit Rregullues nënkupton llogaritjet e strukturave të operacioneve numerike, gjegjësisht prezanton bilancin në nivel të zonës në shumën totale.

Në tabela jepen shënimet për zonat :

A,B,C,D,E,F,G,H,I,J, K, L, M, N, O, P, Q, R , S, T, U, V.

Zonat X mund te planifikohen si hapësira ne zhvillim, për te ardhmen.

Niveli i dytë – Prezanton operacionet urbanistike në nivelin e bllokut të ndërtimit .

Në tabela janë dhënë shënimet për çdo bllok ne veçanti (A1,A2, A3, A4, A5, B1, B2, B3, B4, C1, C2, C3, C4, C5, C6, C7, D1, D2, D3, D4, D5, D6, D7, D8, E1, E2, E3, E4, E5, E6 ,F,G1,G2,G3, G4, H1, H2, H3, H4, I1, I2, I3, I4, I5, I6, I7, I8, J1,J2, J3, K1, K2, K3, L1, L2, M1, M2, M3, M4, M5, M6, M7, M8, N1, N2, O1, O2, O3, O4, O5, O6, P1, P2, P3, P4, P5, P6, P7, P8, P9, P10, Q, R1, R2, R3, S1, S2, S3, T, U, V1, V2).

Niveli i tretë – Organizohet nga pronarët , ku kjo sipërfaqe brenda vijës rregulluese duhet të jetë mbi 200 m². Shënimet për kapacitetet e ndërtimit janë dhënë sipas parametrave urbanistik në mënyrë tabelore për çdo bllok në mënyrë të veçantë.

NDARJA NË ZONA DHE KARAKTERISTIKAT E TYRE

Tërësia urbane A - Karakterizohet si zone për banim me një kapacitet të dendur si dhe me përmbajtje përcjellëse si: (afarizëm, tregti, etj). Në këtë zonë urbane janë prezente objekte të ndërtuara në periudhën e mëhershme të para luftës ,përveç të disa objekteve të cilat gjinden pranë "Rrugës se Prishtinës" të cilat kanë karakter të dobët ndërtimi dhe etazhitet jo të përshtatshëm për këtë zone urbane. Kjo zonë urbane kufizohet me rrugën kryesore "Rruga e Tiranës" dhe pjesa tjetër kufizohet me "Rrugën e Prishtinës"

Tërësia urbane B – Karakteri i kësaj zone është gjithashtu me përmbajtje të përzier mirëpo duhet të ceket se në këtë zonë është paraparë që të rritet përqindja e përmbajtjes së afarizmit, kjo zonë gjendet në pjesën veriperëndimore, me fjalë të tjera përkufizohet prej dy rrugëve kryesore, me: "Rrugën e Prishtinës", dhe "Rrugën e Tiranës". Në kuadër të kësaj tërësie urbane është edhe objekti i Komunës se Shtimes, dominojnë objekte të ndërtuara nga materiali i relativisht i dobët që i takojnë periudhës para viteve 90-ta e më herët, prandaj edhe është propozuar që këto objekte të rrënohen ashtu që parcelat të shfrytëzohen në mënyre maksimale, strategji kjo e cila është në interesin e pronarëve të parcelave dhe komunës.

Tërësia urbane C Kjo zone ka përmbajtje te përzier si: banim, afarizëm, tregti, veprimtari këto te zhvilluara ne objektet përreth "Rrugës se Tiranës" .Ne këtë zone nuk ka ndonjë objekt me vlera historike, monumentale apo arkitekturale, mirepo dominojnë objekte me etazhitet te ulet te cilat nuk janë te përshtatshme për këtë zone.

Tërësia urbane D – Ne këtë tërësi urbane gjenden disa objekte publike siç janë: Shkolla Fillore "Emin Duraku", Stacioni Policor, Shtëpia e shëndetit, Enti për Pune dhe Mirëqenie Sociale. Pjesa tjetër e kësaj zone ka objekte banimi me etazhitet te ulet.

Tërësia urbane E - Karakterizohet si zonë me përmbajtje të banimit me objekte me etazhitet te ulet dhe po ashtu karakterizohet me një pishine te hapur.

Tërësia urbane F – Kjo zone karakterizohet me një dendësi te vogël te objekteve te banimit me etazhitet te ulet..Ne kuadër te kësaj zone ekziston një shkolle fillore.

Tërësia urbane G – Kjo zone është e pa ndertua.Brenda kësaj zone ekziston një siperfaqe prej 1ha e cila është sipërfaqe e varrezave. Ne zonën G është parapare ndërtim i objekteve te banimit me lartësi dhe dendësi te specifikuar ne pjesën grafike.

Tërësia urbane H – Kjo zone është ne perimetrin e rrugës transite, është zone e pa ndërtuar, me plan rregullativ parashihet qe te krijohet zone biznesi.

Tërësia urbane I – Kjo zone karakterizohet me dendësi te vogël te objekteve te banimit, ne kuadër te kësaj zone ekzistojnë edhe: Shkolla fillore, Xhamia, shtëpia për te moshuar. Ne kuadër te kësaj zone është një sipërfaqe relativisht e madhe prej 19ha, me gjelbërim te larte - pishe

Tërësia urbane J – Kjo zone karakterizohet me objektin e administratës se "Pastërtia", tregun e gjelbër dhe tregun e rërës. Një pjese e kësaj zone urbane është e banuar, banimi është ne objekte me etazhitet te ulet.

Tërësia urbane K – Kjo zone karakterizohet me objektet e Entit Special ne pjesën përreth rrugës "Tirana" dhe ne pjesën tjetër është i orientuar banimi individual ne shtëpi private me etazhitet te ulet.

Tërësia urbane L – Kjo zone shtrihet përreth rrugës "Tirana" është e karakterizuar me dendësi te vogël ne brendësi dhe me densitet te shtuar dhe me objekte me te larta përreth rrugës "Tirana". Ne brendësi te zonës janë objektet te banimit me etazhitet te ulet.

Tërësia urbane M –.Zona M ka dendësi te madhe, ne anën lindore përkufizohet me lumin "Shtimjanka", ne kuadër te kësaj zone gjendet "Sheshi i UÇK-së" , objekti i PTK-se dhe objekti i Shoqatave, Xhamia, pjesa tjetër është me objekte te banimit dhe objekte afariste përreth "Rrugës se Tiranes"

Tërësia urbane N – Karakterizohet me: një objekt banimi me etazhitet te larte P+8, objektin e shkollës fillore, Kishën Ortodokse, terrene sportive dhe hapësirë te lire për ndërtim.

Tërësia urbane O – Ka një numër të vogël të objekteve të banimit me etazhitet të ulët. Në kuadër të kësaj zone gjendet Shkolla e Mesme, një Çerdhe private, Qendra për Regjistrim Civil dhe Varrezat e Qytetit.

Tërësia urbane P – Karakterizohet me përmbajtje mikse: banim dhe afarizëm. Objektet e banimit janë me një etazhitet të ulët. Në kuadër të kësaj zone gjendet edhe një stacion i karburanteve dhe disa depo të materialit ndërtimor.

Tërësia urbane Q – Është zone e lire, e pa ndërtuar.

Tërësia urbane R – Karakterizohet me përmbajtje mikse: banim dhe afarizëm. Objektet e banimit janë me një etazhitet të ulët, në kuadër të kësaj zone gjenden veprimtari tregtare.

Tërësia urbane S – Karakterizohet me përmbajtje industriale, në kuadër të kësaj zone ekziston fabrika e ngjyrave dhe materialeve për suvatim dhe Zona industriale e planifikuar.

Tërësia urbane T – Kjo zone ka dendësi shumë të ulët të objekteve të banimit me etazhitet të ulët dhe ka një sipërfaqe të lire të gjelbëruar me gjelbërim të lartë.

Tërësia urbane U – Kjo zone karakterizohet me një objekt hotelier dhe sipërfaqja tjetër është e destinuar për zone biznesi.

Tërësia urbane V – Karakterizohet me përmbajtje afariste dhe tregtare, është zone biznesi.

KARAKTERISTIKAT E ZONAVE URBANE

Nëse bazohemi në karakteristikat e zonave urbane këto zona duhet të zgjidhen sipas standardeve evropiane dhe të plotësojnë kushte si vijon:

- Përcaktimi i masave të shfrytëzimit të infrastrukturës dhe pajisjeve të tyre
- Realizimi i kushteve optimale për përcaktimin e sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit
- Planifikimi i kushteve optimale për largimin e mbeturinave dhe krijimi i kushteve për qytetarin në vizura, ajrosje dhe insolinim.
- Vendosja e rendit kadastral për parcelat e mbetura në kuadër të bllokut të cilat duhet të jenë të qarta dhe precize.

Zonat e ndërtimit – Janë blloqet e pavarura për ndërtim në këtë tërësi urbane dhe janë të prezantuara në formë tabelore. Shënimet e sakta për madhësinë përfshirëse, kushtet e shfrytëzimit, kriteret dhe etazhiteti janë dhënë në mënyrë tabelore për çdo bllok.

Vijat ndërtimore dhe rregulluese – janë të prezantuara me shtojca grafike. Vijat rregulluese dhe ndërtimore si dhe largësitë në mes tyre janë prezantuar me saktësi dhe matje gjeodezike.

RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË PARCELAVE

Sipas parimeve të përgjithshme treguesit themelor urbanistik në të cilët bazohet rregullimi i parcelave janë:

- ISHP – Indeksi i shfrytëzimit të parcelës
- ISD – Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë
- Vija rregulluese
- Vija ndërtimore

ISHP – Indeksi i shfrytëzimit të parcelës paraqet sipërfaqen e lejuar për ndërtim (shputa e objektit) në kuadër të sipërfaqes së parcelës që përfshihet brenda vijës rregulluese.

ISD – Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë paraqet koeficientin me të cilin shumëzohet sipërfaqja e parcelës brenda vijës rregulluese për të fituar sipërfaqen totale të lejuar për ndërtim.

Shfrytëzimi i nëntokës paraqet përqindjen e lejuar të shfrytëzimit të sipërfaqes së parcelës e cila përfshihet brenda vijës rregulluese duke respektuar vijën ndërtimore nën nivelin e përdhesisë.

Shfrytëzimi i mbi tokës paraqet përqindjen e lejuar të shfrytëzimit të sipërfaqes së parcelës e cila përfshihet brenda vijës rregulluese duke respektuar vijën ndërtimore.

Vija rregulluese

Tregon vijën e ndarjes së parcelës për interes të përbashkët dhe për interes të veçantë të bllokut. Vija rregulluese siguron nga njëra anë funksionimin normal të aktiviteteve në hapësirat me interes të përbashkët (komunikacionit) ndërsa nga ana tjetër mbron interesin e veçantë.

Vija rregulluese siguron korridorin për vendosjen e rrjetës (primare dhe sekondare) të infrastrukturës (ujësjellësit, kanalizimit, PTT, rrjetit të gazit, ngrohjes, e të ngjashme).

Plani rregullues definon kuotat e domosdoshme të niveleve për sigurimin e kyçjeve të objekteve në fazën e projektimit urbanistik-arkitektonik.

Përcaktimi i vijës rregulluese

- Vija rregulluese dhe boshti i komunikacionit përbëjnë bazat e elementeve për përcaktimin e rrjetit të komunikacionit
- Largësia në mes të vijave rregulluese (gjerësia e shiritit rregullues) është përcaktuar varësisht nga funksioni dhe rangi i rrugës
- Vija rregulluese definohet si horizontale, vertikale, mbitokësore dhe nëntokësore
- Largësia në mes të vijave rregulluese (gjerësia e shiritit rregullues) në zonat e planifikuara i ka këto vlera:
 - **Rregullacioni më i vogël i lejuar është më së paku 8.0 m**
 - **Për rrugët banesore më së paku 8.0m**
 - **Rrugët përmbledhëse më së paku 10.0 m**
 - **Për rrugët interne (rrugë të këmbësorëve) më së paku 6.0 m**

Vija ndërtimore

Përcaktohet me këtë plan rregullues dhe është meritore për projektin urbanistik dhe lejen urbanistike. Në dokumentacionin e cekur me këtë plan, vija ndërtimore përcaktohet në raport me vijën rregulluese. Vija ndërtimore mund të përputhet me vijën rregulluese ose mund të jetë në largësi të përcaktuar në shtojcën grafike për çdo bllok veçanërisht. Çdo objekt ndërtimor i planifikuar duhet të jetë i vendosur me fasadën e përparme në vijën ndërtimore respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore.

Distanca anësore e objekteve të banimit kolektiv

Distanca në mes të objekteve kolektive të banimit përcaktohet nga lloji i objekteve:

- a) për objektet në seri, të pandërprerë, është 0.00m
- b) objektet në serinë e ndërprerë, më së paku 5.00m
- c) objekte të veçanta, është min 8.0m (në përputhje me kushtet e insolimit)
- d) objektit kolektiv nga objekti tjetër i çfarëdo tipi të ndërtimit apo objektit jo banesore, duhet të jetë më së paku 8.00m (në përputhje me kushtet e insolimit)

Lartësia e objektit

Lartësia e objektit është niveli nga kuota zero e objektit deri në kulm (për objektet me kulm të pjerrët) respektivisht deri te kurora (për objektet me kulm të rrafshët). Ndërsa lartësia e objekteve jo banesore d.m.th. me destinim të përzier është e përcaktuar me këtë plan përmes parametrave të përcaktuar ISHP dhe ISD për secilin bllok në veçanti.

Kulmi i objekteve

Kulmet mund të jenë të pjerrëta dhe të rrafshëta, ndërsa preferohet që kulmet e shfrytëzuara të tërhiqen brenda gabaritit të etazhës së fundit duke formuar terasa të brendshme.

Niveli i përdhësës në raport me nivelin e rrugës publike

Niveli ± 0.00 e përdhësës së objektit përcaktohet në raport me nivelin e rrugës publike:

1. Niveli i përdhësës së objektit nuk mund të jetë më i ulët se niveli i rrugës publike
2. Niveli i përdhësës mund të jetë më së larti 1.20m nga niveli i rrugës
3. Objektet të cilat në përdhese kanë destinim afarist, niveli mund të jetë më i lartë se niveli i trotuarit për më së tepërmi 0.20m

Daljet nga gabariti i objektit

Konzolat mbi nivelin e përdhesis mund të kalojnë vijën ndërtimore respektivisht vijën rregullative deri 1.50 m. Reklamat si konzolla lejohen dalje nga gabariti themelor i objektit max 1.20m dhe në lartësi jo më të ulët se 3.0 m (pjesa e poshtme e reklamës). Elementet ndërtimore nën kuotën e trotuarit dhe etazhet e bodrumeve, mund të kalojnë vijën ndërtimore duke llogaritur nga gabariti themelor i objektit deri te projeksioni horizontal i daljes dhe atë:

- shputat e themelit nuk munden të kalojnë kufirin e parcelës fqinje
- pusetat ndriçuese të hapësirave të bodrumit deri në nivelin e kotës së trotuarit mund të kalojnë vijën ndërtimore respektivisht rregulluese më së tepërmi 1.00 m. Duhet te kihet parasysh që këto puseta të jenë në nivel të trotuarit.

Rrethojat

- Parcelat ndërtimore të objekteve kolektive banesore, afariste dhe objekteve tjera publike, përveç shkollave, institucioneve parashkollore, etj. nuk rrethohen.
- Rrethojat në parcelat ndërtimore në të cilat ndodhet objektet sociale (shkolla, institucionet për fëmijë, të rrethohen me rrethojë-mur në lartësi deri 0.80m (duke llogaritur prej nivelit të trotuarit) apo rrethojën transparente deri në lartësi 1.50 m, por edhe forma të kombinuara të formësimit dhe dizajnit urb-arkitektonik duke respektuar lartësitë e cekura..
- Rrethojat e objekteve të cilat gjenden në këndet e parcelave ku pengohen vizurat nuk mund të jenë më të larta se 0.80m duke u llogaritur nga kuota e trotuarit, për shkak të perceptimit vizual.

Etazhiteti i objekteve

Përcaktohet duke respektuar koeficientet ISHP dhe ISD të përcaktuar për secilën zonë.

Te gjitha ndërtesat mund të kenë etazhën e bodrumit, përveç në rastet kur kjo është e pamundur për shkak të nivelit të lartë të ujërave nëntokësore dhe shkaqeve tjera teknike.

Parkimi dhe garazhimi për objektet kolektive të banimit në blloqe

Parkimi i makinave duhet të sigurohet në brendi të bllokut për nevojat e pronarëve të objekteve kolektive të banimit dhe të gjitha objekteve tjera të cilat kanë karakter shfrytëzues. Tek objektet kolektive të banimit, parkimi respektivisht garazhimi është një parking për një banesë me kusht që së paku 80% e makinave të jetë në

garazha. Garazhet e objekteve kolektive vendosen në ose nën objektet në gabaritin e objektit apo nën tokë jashtë gabaritit të objektit.

ZONAT SIPAS DESTINIMEVE TË ZGJEDHJES URBANE

Destinimi i Zonave urbane të hapësirës urbane të qytetit të Shtimes me koncept themelor në aspektin funksional, organizativ dhe të formësimit është i bazuar në Planin Zhvillimor Urban dhe në bazë të hartimit të projekteve dhe ndërtimit kronologjik të kësaj hapësirë urbane duke u plotësuar dhe ndryshuar sipas destinimit të prezantuar me këtë projekt.

Objektet kryesisht janë të ndërtuara sipas zgjidhjes urbanistike të Planeve Detale Urbanistike të mëhershme. Përveç këtyre ekzistojnë edhe objekte të cilat do të mbesin siç janë, objektet e banimit kolektiv dhe individual, objektet e ndërmarrjeve publike PTK, Komuna, qendra tregtare, etj.

TRAFIKU DHE TRANSPORTI

Rekomandimet e përgjithshme:

- Të ndërtohet sipas kërkesës së Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Të ri asfaltohen rrugët të cilat janë zgjeruar, sidomos ato primare.
- Të gjitha parkingjet ekzistuese duhet të sinjalizohen sipas rregullave të parapara.
- Të ndërtohen trotualet në dy anët e rrugëve primare.
- Të vendosen shenjat e emërimit të rrugëve.
- Të vendosen pengesat e shtruara në rrugë, sipas standardeve të parapara të cilat pamundësojnë lëvizjen me shpejtësi të madhe.
- Të caktohen kahet si të rrugëve primare ashtu edhe sekondare sepse mundësitë teknike ekzistojnë.
- Të vendosen shenjat në kryqëzimin e rrugëve .
- Shfrytëzimi i sipërfaqeve të pashfrytëzuara për parkingje.
- Në rrugët të cilat janë të ngushta, duhet të formohet xhepi i cili mundëson kalim të sigurt.
- Shumica e rrugëve që nuk kanë dalje të sinjalizohen me shenjë të komunikacionit pa dalje. Kjo infrastrukturë rrugore momentale mundëson zhvillimin e një transporti të tillë publik që do ta lidhte qendrën me pjesët tjera të qytetit. Që gjatë zgjerimeve të rrugëve të rregullohet njëkohësisht edhe kanalizimet dhe i gjithë rrjeti i infrastrukturës nëntokësore dhe mos të tenderohet pa i llogaritur edhe këtë infrastrukturë.

INFRASTRUKTURA HIDROTEKNIKE

RRJETI PËR FURNIZIM ME UJË TË PIJES

Për të bërë planifikimin e rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Shtimes jemi bazuar nga të dhënat e anketimit me qytetarë si dhe nga Plani zhvillimor i Urban.

Sipërfaqja e zonës urbane:

Sipas matjeve të bëra nga ekipet në terren del se sipërfaqja e tërësishme e kësaj hapësire është ~ 1531 ha.

Numri i banorëve:

Sipas një ankete të bërë me banorët mendohet se në zonën kadastrale të Shtimes momentalisht jetojnë 15 000 banorë

Furnizimi:

Komuna e Shtimes furnizohet nëpërmes ujërave nëntokësor nga rrjeti i ujësjellësit dhe një pjesë furnizohen nga puset vetanake të banorëve.

Norma e harxhimit të ujit:

Norma e harxhimit të ujit për një banor merret :

$$N=130\text{l/b/dite}$$

Koeficienti i jo njëtrajtshmërisë:

$$K=1.55$$

$$Q_{mes}=40\text{(l/s)}, Q_{max}=55\text{(l/s)},$$

Humbjet në rrjetë:

Humbjet në rrjetë merren gjithsej 20% të prurjeve të përgjithshme:

$H_{mes}=8$ (l/s), $H_{max}=11$ (l/s),

Diametri maksimal i tubave kryesor furnizues me ujë për tere qytetin është Ø280mm

RRJETI PËR LARGIMIN E UJËRAVE TE ZEZA DHE ATMOSFERIKE

Për planifikimin e rrjeteve hidroteknike jemi bazuar:

- Të dhënat nga anketimi me qytetarë
- Plani Zhvillimor Urban

Kullimi i ujërave sipërfaqësor nga parcelat bëhet me rënje të lirë nga rigollat, respektivisht kah rruga me rënje më të vogël prej 1.5 %. Ujërat sipërfaqësor nga një parcelë ndërtimore nuk mund të drejtohen kah parcela tjetër, përveç në raste kur një zgjidhje e tillë është e përcaktuar me plan.

Ujërat e zeza

Nga të dhënat e sipërshënuara është parë se vetëm në qendrën e qytetit ujerat e zeza janë të ndara me ujerat atmosferike, kurse pjesa tjetër e sipërfaqes së tërësishme të rrjetit të kanalizimit të ujerave të zeza është e kombinuar d.m.th. ujerat zeza janë të përziera me ujëra atmosferike.

Rekomandohet që:

Të gjitha këto rrjete duhet të ndahen (rrjeti i kanalizimit të ujerave të zeza dhe rrjeti i kanalizimit atmosferik).

Lartësia në mes të pusetave sipas rregulloreve për diametra të ndryshëm duhet të jenë:

Nr.	Diametri i jashtëm i gypave (mm)	Lartësia ne mes pusetave (m)
1.	125	35
2.	150-600	50
3.	700-1000	75

Lloji i materialit

Rrjeti për largimin e ujërave zeza është i punuar më gypa të beton armesë me diametra të ndryshëm dhe gypa të polietilenit.

Gjendja ekzistuese

Gjendja ekzistuese e kanalizimit të ujërave të zeza mund të konstatohet e mjerueshme. Marrë në një përqindje (sipas shënimeve të marra, afër **80%** e kanalizimit të ujërave të zeza është i përzier me kanalizimin atmosferik).

Vërejtje:

Është e detyrueshme që të bëhet ndarja e kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferik. Përveç kësaj propozohet që të bëhet edhe ndryshimi i gypave prej gypa BA (beton arme) në gypa polietileni, në ato pjesë ku nuk janë të ndërruar.

RRJETI TERMOENERGJETIK

Furnizimi i ngrohjes qendrore në objektet e banimit dhe objektet afariste duhet të bëhet nga Ngrohtorja e Qytetit e cila duhet të llogaritet në nivel të kapacitetit të qytetit në një të ardhme të afërt.

Përgatitja e ujit të nxehtë bëhet me kaldajë ngrohëse e cila punon me lëndë djegëse mazut.

Furnizimi me ujë të nxehtë i këmbyesve të objekteve bëhet me $t=140\text{ }^{\circ}\text{C}$ furnizim, ndërsa kthimi me $60\text{ }^{\circ}\text{C}$.

Furnizimi i objekteve duhet të bëhet me anë të gypave të cilët i furnizojnë këmbyesit e nxehtësisë të cilët duhet montuar në bodrumin e objekteve,

Prej këmbyesve me anë të pompave bëhet shpërndarja e ngrohjes qendrore nëpër objektet e banimit dhe objektet afariste

SIPERFAQET E GJELBRUARA

1. Sipërfaqet dekorative te qytetit 14-18L/m²
2. Sipërfaqet e mbjella me lule 14-18L/m²
3. Larja e shesheve ne dite te nxehta 2L/m²
4. Drurët e porsa mbjelle ne tri vitet e para me 6-10 ujitje ne dite, 18-27L/dru

Për shkak të sipërfaqeve të mëdha të gjelbëruara, dhe në anën tjetër duke marrë në konsideratë shpenzimet e mëdha të ujit për pije preferohet që për këto sipërfaqe, auto larje, larjen e rrugëve dhe trotuareve të gjendet mundësia e hulumtimit të ujërave nëntokësore. Këto ujëra të kapen me anën e shpimeve dhe të përdoren për destinim të caktuar.

Ne baze të gjithë kësaj del se sasia e nevojshme për të furnizuar me ujë të pijes është:

$$Q_{mes/ditë}=68.000(l/s)$$

Konkludim:

Në bazë të shënimeve të sipërshënuara konkludojm se : diametri **Ø300mm** i plotëson kushtet e nevojshme për të furnizuar me ujë qytetin.

RRJETI ELEKTROENERGJETIKË

Rekomandimet e master planit për zhvillimin e sistemit distributiv të Kosovës deri më vitin 2015, që përfshinë:

- Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV
- Kalimin nga rrjeti distributiv 10 kV në rrjetin distributiv 20kV
- Zëvendësimin e TS 10/0.4 kV me ato 20/0.4kV
- Zëvendësimi i linjave ajrore 230/400V me kablllo te perdredhur apo edhe kablllo nëntokësore.

Në qoftë se qyteti zgjerohet do të zgjerohej, duhet të parashihet po ashtu zgjerimi i ngarkesave dhe zgjerimi i daljeve 10kV.

Trafostacioni ekzistues është e mbingarkuar dhe në projektet tona të ardhme është paraparë kalimi në nivelin prej 35kV në nivelin 110 /20(10)kV. Për momentin ky trafostacion furnizon Qendrën e qytetit.

Propozimi është që trafot të vendosen ne pjesën e kufizuar me hekurudhën duke i futur ne përdorim trafo prej 600 KVA. Kjo për arsyet te zgjerimit te qytetit ne te ardhmen.

NDRIÇIMI

Në projektimin e rrugëve është përcaktuar edhe mënyra e ndriçimit artificial. Ndriçimi artificial nuk duhet të verbojë e as të pengojë shikimin. Për të pasur një ndriçim sa më të njëtrajtshëm, ndriçuesit duhet të jenë sa më lart sipërfaqes së tokës. Largësia e shtyllave ndryshon varësisht nga gjerësia e rrugëve. Shtyllat të vendosen 1.0 - 1.5 m larg nga bordurat. Vendosja e tyre duhet të shkojë sipas ritmit te drunjve. Mënyra e ndriçimit varet nga gjerësia e rrugëve. Për rrugë me gjerësi deri në 12 m ndriçuesit vendosen vetëm në një anë të rrugës. Për rrugë me gjerësi deri 18 m ndriçuesit varen mbi rrugë dhe për gjerësi mbi 40 m ndriçuesit vendosen në të dy anët e rrugëve. Ndriçimi në kryqëzimin e rrugëve duhet të jetë më i fuqishëm se ndriçimi i rrugës që kryqëzohet. Ndriçimi në këto nyje mund të jetë i ndryshëm nga ai i rrugëve. Ndriçimi i shesheve duhet të jetë 50 % më i fortë se ai i rrugëve që hyjnë në të.

Treguesit e përafërt të ndriçimit të rrugëve janë:

- për rrugë kryesore qytetesh 4-8 luks/m²
- për rrugë banimi 1-2 luks/m².

GJELBËRIMI

Gjelbërimi duhet që ti përgjigjet kushteve konkrete të lagjes, sipas llojit dhe gjerësisë së rrugëve, nga ngarkesa e lëvizjes, nga etazhiteti, lloji dhe karakteri i tyre, nga faktorët e klimës si dhe nga kushtet sanitaro-higjenike.

Si faktor kryesor që ndikon në mënyrën e projektimit të gjelbërimit rrugor kemi marrë orientimin e rrugëve ekzistuese të lagjes “Qendra”.

Gjelbërimi i rrugëve duhet të bëhet në të dy anët e trotuarit për të mbrojtur banorët nga zhurmat e krijuara nga komunikacioni si dhe këmbësorët nga rrezet e diellit në ditët e nxehta.

Brezat e gjelbërimit të vazhdueshëm gjatë gjithë trotuarit duhet të kenë një gjerësi për një rresht me gjerësi prej 2.0 m, ndërsa për shkurret brezi i gjelbër duhet të jetë i gjerë 0.8-1.50 m. Lloji i gjelbërimit duhet të zgjidhet në varësi të arkitekturës dhe lartësive të ndërtesave. Ritmet dhe largësia ndërmjet drunjve duhet të merret e tillë që të mos mbulojë krejtësisht fasadat e objekteve, por duhet që, me formën dhe madhësinë e tyre të theksojnë vlerat arkitektonike. Drunjtë duhet të jenë të tillë që të mirëmbahen lehtë dhe ti përshtaten kushteve klimatike të vendit. Drunjtë duhet të jenë fidane dyvjeçare. Ndër drunjtë që përdoren më së shumti për shëtitore janë: bliri, gështenja e egër, pisha e butë, ahu etj; ndërsa për rrugë banimi janë: pisha e butë, shelgu, robinja etj.

Rekomandohet : mirëmbajtje më e mirë qoftë nga kompania publike, banorët apo pronarët e lokaleve afariste, sensibilizimi i banorëve rreth mbrojtjes së ambientit, inventarizimi i drunjte ekzistues dhe krijimi i një baze të dhënave rreth gjelbërimit të lartë, rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe harmonizimi i tyre.

INTERVENIMET DHE RINOVIMET

Objekte ekzistuese publike , nga aspekti socialo-ekonomik të rinovohen në frymë dhe koncepte të reja me standarde teknike dhe fizikë ndërtimore sipas standardeve të reja.

REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

- Gjatë zgjerimeve të rrugëve të rregullohet njëkohësisht e gjithë infrastruktura nëntokësore
- Të riaktivizohet dhe të rivendoset ndriçimi adekuat në hapësirat dhe sipërfaqet publike
- Të largohen të gjitha llojet e përçuesve dhe kablllove ajrorë
- Shtigjet e këmbësorëve të pllakëzohen
- Të vendoset sinjalizimi horizontal dhe vertikal
- Të pastrohen apo montohen ulluqet horizontale dhe vertikale në ndërtesa
- Të largohen panot dhe reklamat pa leje që paraqesin pengesë për banorët dhe konsumatorët
- Të vendosen pllakat me emërtimet e rrugëve
- Të largohen antenat satelitore dhe elementet e tjera që prishin dukjet e ndërtesave.
- Të vendosen pajisjet e lojërave dhe rërës për fëmijë në kuadër të sipërfaqeve gjelbëruese
- Të pastrohen, të ripërtërihen dhe të kultivohen sipërfaqet gjelbëruese para objekteve
- Të mirëmbahet gjelbërimi ekzistues dhe të krijohet tamponi gjelbërues
- Të vendosen bankat për ulje dhe pushim pranë shtigjeve të këmbësorëve në kuadër të sipërfaqeve gjelbëruese
- Të pastrohen mbeturinat – të vendosen kontejnerët e mbeturinave
- Zgjerimet e lokaleve afariste dhe hapësirave publike të rrënohen – të kthehen në gjendjen e projektuar.
- Hapësirat e përmbajtjeve publike – të lirohen dhe të vendosen në funksionin e projektuar

PARCELA NDËRTIMORE DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PARCELIMIT

Njësia më e vogël ku mund të ndërtohet është parcela ndërtimore. Parcela ndërtimore është njësia më e vogël ku mund të ndërtohet. Parcela minimale për ndërtim duhet të ketë minimumi $200 m^2$. Për arritjen e sipërfaqes minimale të parcelës ndërtimore duhet të bëhet grupimi me parcela fqinje dhe si të tilla duhet të regjistrohen në librat kadastral. Parcelat me formë të çrregullt gjeometrike dhe që nuk e kanë front (daljen në rrugë) më të gjerë se **7.5m** duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim. Me këtë plan rregullues është përcaktuar me prioritet, parcelimi në interesin e përgjithshëm (parcelat e rrugëve publike, sipërfaqeve të gjelbëruara, parcelat për objekte të interesit publik etj). Sipërfaqja e parcelës e cila përfshihet brenda vijës rregulluese është bazë për llogaritjen e përqindjes në pjesëmarrjen e ndërtimit të një blloku. Objektet që gjinden në kuadër të parcelës ekzistuese nuk kanë vlerë në përcaktimin e pjesëmarrjes në përqindjen e sipërfaqes së bllokut.

Parcela ndërtimore

Definohet me vijën rregulluese ndaj rrugës publik, kufijve të parcelave ndaj parcelave të fqinjëve dhe të gjitha pikave thyese të nevojshme për shënim në teren.

TREGUESIT E PËRGJITHSHËM TË NDËRTIMIT SIPAS ZONAVE

Zona A

Blloku A1

Hapësira për banim kolektiv dhe afarizëm

Kushtet e përgjithshme

Destinimi: Banim kolektiv, afarizëm, tregti dhe funksione përcjellëse (parking, garazhim, hapësira për lojëra të fëmijëve, sipërfaqe të gjelbëruara).

Lejohet: Ndërtimi i objekteve me etazhitet të ndërtimit B+P+6, duke respektuar koeficientët e përcaktuar $ISD_{max}=2.8$, $ISHP_{1,max}=40\%$ dhe $ISHP_{2,max}=50\%$ (llogaritja e ISHP është bërë duke u bazuar në sipërfaqen e lejuar për ndërtim brenda vijës ndërtimore), me destinim të përzier (Banim kolektiv, dhe afarizëm) me hapësirat përcjellëse për banorë, si dhe shfrytëzimi i një pjese të hapësirës për gjelbërim dhe rekreacion, hapësirat e parkingjeve, rrugëve interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë. Hapësirat e rezervuara komunale për infrastrukturë (ujësjellës, kanalizim, ngrohje, rrymë, telefoni, sistemi kabllorik). Meqenëse ky bllok ka pozitë përballë rrugës me karakter kryesor, duhet të formohen oaza të gjelbërimit dhe sheshe që e gjallërojnë këtë ambient. Përdhesa shfrytëzohet për afarizëm, tregti si dhe katet e sipërme për banim. Pasi kemi të bëjmë edhe me objekte ekzistuese të ndërtuara më parë, me këtë plan këto objekte do të inkorporohen si të tilla dhe në rast të rrënimit të tyre duhet respektuar vija ndërtimore dhe koeficientet e përcaktuar në këtë Plan Rregullues.

Kushtet e veçanta

Parcela me sipërfaqe $Sp=400m^2$ është parcela me sipërfaqe minimale në të cilën lejohet ndërtimi i objektit $ISD_{max}=2$, parcelat që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 10m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim, ndërsa për shtëpi në varg parcela me sipërfaqe minimale $Sp=200m^2$ $ISD_{max}=2$. Për parcelat me $Sp=200m^2$ që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 7.5m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim. Arkitektura e objekteve duhet të jetë në harmoni me objektet ekzistuese të bllokut dhe zonës në tërësi si dhe të jetë sipas destinimit të caktuar të bllokut. Për zgjidhjet parciale shfrytëzohen të njëjtit koeficient të bllokut, kurse llogaritja e sipërfaqeve të ndërtimit bëhet në proporcion me përqindjen e pjesëmarrjes së parcelës në sipërfaqen e tërësishme të bllokut.

Tabela e llogaritjes se parametrave urban		
Zona		A
Blloku		A1
Sipërfaqja e bllokut ndërtimor (m ²)		77351
Sipërfaqja ku lejohet ndërtimi (m ²)		66081
Shfrytëzimi i nëntokës (%)		70%
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₁ = 0.3)		40%
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₂ = 0.4)		50%
Etazhiteti max. i lejuar		B+P+5
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		251108
Shputa (m ²)		26432
Bodrumi		46257
Destinimi	Banim	75%
	Afarizëm	25%
Banimi	Sipërfaqja totale (m ²)	188331
	Numri i vend parkimeve (1 vendparkim / 1 apartament)	2511
	Numri i banoreve	7533
Afarizmi	Sipërfaqja totale max. (m ²)	62777
	Numri i vend parkimeve (1 vendparkim / 100m ²)	628
Vërejtje	Indeksi ISHP ₁ paraqet indeksin e shputës ne Përdhesa dhe ne katin e pare, ndërsa indeksi ISHP ₂ paraqet indeksin për katet tjera, qe nënkupton konzolat	

Totali i parametrave urban		
Zona		A
Blloku		A1
Sipërfaqja totale e bllokut (m ²)		77351
Indeksi i shfrytëzimit te dyshemesë (ISD)		3.8
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP)		0.4
Raporti	Banimi	70%
	Afarizmi	30%
Numri i banoreve		7533
Numri i vend parkingjeve		2511
Shputa (m ²)		26432
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		251108
Dendësia e banimit (banore/ha)		974

Zona A

Blloku A2

Hapësira për banim individual dhe afarizëm

Kushtet e përgjithshme

Destinimi: Banim individual, afarizëm dhe funksione përcjellëse (parking, _garazhim, hapësira për lojëra të fëmijëve, sipërfaqe të gjelbëruara).

Lejohet: Ndërtimi i objekteve me etazhitet të ndërtimit B+P+2, duke respektuar koeficientët e përcaktuar $ISD_{max}=2.0$, $ISHP_{1,max}=40\%$ dhe $ISHP_{2,max}=50\%$ (llogaritja e ISHP është bërë duke u bazuar në sipërfaqen e lejuar për ndërtim brenda vijës ndërtimore) , me destinim të përzier (Banim individual, dhe afarizëm) me hapësirat përcjellëse për banorë, si dhe shfrytëzimi i një pjese të hapësirës për gjelbërim dhe rekreacion, hapësirat e parkingjeve, rrugëve interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë. Hapësirat e rezervuara komunale për infrastrukturë (ujësjellës, kanalizim, ngrohje, rrymë, telefoni, sistemi kabllor). Duhet të formohen oaza të gjelbërimit dhe sheshe që e gjallërojnë këtë ambient. Pasi kemi të bëjmë edhe me objekte ekzistuese të ndërtuara më parë, me këtë plan këto objekte do të inkorporohen si të tilla dhe në rast të rrënimit të tyre duhet respektuar vija ndërtimore dhe koeficientet e përcaktuar në këtë Plan Rregullues.

Kushtet e veçanta

Parcela me sipërfaqe $Sp=400m^2$ është parcela me sipërfaqe minimale në të cilën lejohet ndërtimi i objektit $ISD_{max}=2$, parcelat që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 10m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim, ndërsa për shtëpi ne varg parcela me sipërfaqe minimale $Sp=200m^2$ $ISD_{max}=2$. Për parcelat me $Sp=200m^2$ që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 7.5m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim. Arkitektura e objekteve duhet të jetë në harmoni me objektet ekzistuese të bllokut dhe zonës në tërësi si dhe të jetë sipas destinimit të caktuar të bllokut. Për zgjidhjet parciale shfrytëzohen të njëjtit koeficient të bllokut, kurse llogaritja e sipërfaqeve të ndërtimit bëhet në proporcion me përqindjen e pjesëmarrjes së parcelës në sipërfaqen e tërësishme të bllokut.

Tabela e llogaritjes se parametrave urban		
Zona		A
Blloku		A2
Sipërfaqja e bllokut ndërtimor (m ²)		14599
Sipërfaqja ku lejohet ndërtimi (m ²)		13065
Shfrytëzimi i nëntokës (%)		60%
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₁ = 0.3)		40%
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₂ = 0.4)		50%
Etazhiteti max. i lejuar		B+P+2
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		16985
Shputa (m ²)		5226
Bodrumi		7839
Destinimi	Banim	75%
	Afarizëm	25%
Banimi	Sipërfaqja totale (m ²)	12738
	Numri i vend parkimeve (1vendparkim / 1 apartament)	170
	Numri i banoreve	510
Afarizmi	Sipërfaqja totale max. (m ²)	4246
	Numri i vend parkimeve (1vendparkim / 100m ²)	42
Vërejtje	Indeksi ISHP ₁ paraqet indeksin e shputës ne Përdhese dhe ne katin e pare, ndërsa indeksi ISHP ₂ paraqet indeksin për katet tjera, qe nënkupton konzolat	

Totali i parametrave urban		
Zona		A
Blloku		A1
Sipërfaqja totale e bllokut (m ²)		14599
Indeksi i shfrytëzimit te dyshemesë (ISD)		2.0
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP)		0.4/0.5
Raporti	Banimi	75%
	Afarizmi	25%
Numri i banoreve		510
Numri i vend parkingjeve		170
Shputa (m ²)		5226
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		16985
Dendësia e banimit (banore/ha)		349

Zona A
Blloku A3

Hapësira për banim individual

Kushtet e përgjithshme

Destinimi: Banim individual dhe funksione përcjellëse (parking, garazhim, hapësira për lojëra të fëmijëve, sipërfaqe të gjelbëruara).

Lejohet: Ndërtimi i objekteve me etazhitet të ndërtimit B+P+2, duke respektuar koeficientët e përcaktuar $ISD_{max}=2.0$, $ISHP_{1,max}=40\%$ dhe $ISHP_{2,max}=50\%$ (llogaritja e ISHP është bërë duke u bazuar në sipërfaqen e lejuar për ndërtim brenda vijës ndërtimore) , me destinim banim individual me hapësirat përcjellëse për banorë, si dhe shfrytëzimi i një pjese të hapësirës për gjelbërim dhe rekreacion, hapësirat e parkingjeve, rrugëve interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë. Hapësirat e rezervuara komunale për infrastrukturë (ujësjellës, kanalizim, ngrohje, rrymë, telefoni, sistemi kabllor). Duhet respektuar vija ndërtimore dhe koeficientet e përcaktuar në këtë Plan Rregullues.

Kushtet e veçanta

Parcela me sipërfaqe $Sp=400m^2$ është parcela me sipërfaqe minimale në të cilën lejohet ndërtimi i objektit $ISD_{max}=2$, parcelat që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 10m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim, ndërsa për shtëpi ne varg parcela me sipërfaqe minimale $Sp=200m^2$ $ISD_{max}=2$. Për parcelat me $Sp=200m^2$ që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 7.5m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim. Arkitektura e objekteve duhet të jetë në harmoni me objektet ekzistuese të bllokut dhe zonës në tërësi si dhe të jetë sipas destinimit të caktuar të bllokut. Për zgjidhjet parciale shfrytëzohen të njëjtit koeficient të bllokut, kurse llogaritja e sipërfaqeve të ndërtimit bëhet në proporcion me përqindjen e pjesëmarrjes së parcelës në sipërfaqen e tërësishme të bllokut.

Tabela e llogaritjes se parametrave urban		
Zona		A
Blloku		A3
Sipërfaqja e bllokut ndërtimor (m ²)		7412
Sipërfaqja ku lejohet ndërtimi (m ²)		4957
Shfrytëzimi i nëntokës (%)		60%
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₁ = 0.3)		40%
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₂ = 0.4)		50%
Etazhiteti max. i lejuar		B+P+2
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		6444
Shputa (m ²)		1983
Bodrumi		2974
Destinimi	Banim	100%
	Afarizëm	0%
Banimi	Sipërfaqja totale (m ²)	6444
	Numri i vend parkimeve (1vend parkim / 1 apartament)	86
	Numri i banoreve	258
Afarizmi	Sipërfaqja totale max. (m ²)	0
	Numri i vend parkimeve (1vendparkim / 100m ²)	0
Vërejtje	Indeksi ISHP ₁ paraqet indeksin e shputës ne Përdhese dhe ne katin e pare, ndërsa indeksi ISHP ₂ paraqet indeksin për katet tjera, qe nënkupton konzolat	

Totali i parametrave urban		
Zona		A
Blloku		A3
Sipërfaqja totale e bllokut (m ²)		7412
Indeksi i shfrytëzimit te dyshemesë (ISD)		2.0
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP)		0.4
Raporti	Banimi	100%
	Afarizmi	0%
Numri i banoreve		258
Numri i vend parkingjeve		86
Shputa (m ²)		1983
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)		6444
Dendësia e banimit (banore/ha)		348

Zona A
Blloku A4

Hapësira për banim individual

Kushtet e përgjithshme

Destinimi: Banim individual dhe funksione përcjellëse (parking, garazhim, hapësira për lojëra të fëmijëve, sipërfaqe të gjelbëruara).

Lejohet: Ndërtimi i objekteve me etazhitet të ndërtimit B+P+2, duke respektuar koeficientët e përcaktuar $ISD_{max}=2.0$, $ISHP_{1,max}=40\%$ dhe $ISHP_{2,max}=50\%$ (llogaritja e ISHP është bërë duke u bazuar në sipërfaqen e lejuar për ndërtim brenda vijës ndërtimore) , me destinim banim individual me hapësirat përcjellëse për banorë, si dhe shfrytëzimi i një pjese të hapësirës për gjelbërim dhe rekreacion, hapësirat e parkingjeve, rrugëve interne, shtigjeve për këmbësorë, hapësirat e lojërave për fëmijë. Hapësirat e rezervuara komunale për infrastrukturë (ujësjellës, kanalizim, ngrohje, rrymë, telefoni, sistemi kabllovik). Duhet respektuar vija ndërtimore dhe koeficientet e përcaktuar në këtë Plan Rregullues.

Kushtet e veçanta

Parcela me sipërfaqe $Sp=400m^2$ është parcela me sipërfaqe minimale në të cilën lejohet ndërtimi i objektit $ISD_{max}=2$, parcelat që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 10m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim, ndërsa për shtëpi ne varg parcela me sipërfaqe minimale $Sp=200m^2$ $ISD_{max}=2$. Për parcelat me $Sp=200m^2$ që kanë formë të çrregullt gjeometrike dhe nuk e kanë frontin (daljen në rrugë) me të gjerë se 7.5m duhet të bashkohen me parcelat fqinje për të krijuar kushtet minimale për ndërtim. Arkitektura e objekteve duhet të jetë në harmoni me objektet ekzistuese të bllokut dhe zonës në tërësi si dhe të jetë sipas destinimit të caktuar të bllokut. Për zgjidhjet parciale shfrytëzohen të njëjtit koeficient të bllokut, kurse llogaritja e sipërfaqeve të ndërtimit bëhet në proporcion me përqindjen e pjesëmarrjes së parcelës në sipërfaqen e tërësishme të bllokut.

Tabela e llogaritjes se parametrave urban		
Zona	A	
Blloku	A4	
Sipërfaqja e bllokut ndërtimor (m ²)	39548	
Sipërfaqja ku lejohet ndërtimi (m ²)	34363	
Shfrytëzimi i nëntokës (%)	60%	
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₁ = 0.3)	40%	
Indeksi i shfrytëzimit te parcelës (ISHP ₂ = 0.4)	50%	
Etazhiteti max. i lejuar	B+P+2	
Sipërfaqja totale ndërtimore (m ²)	44672	
Shputa (m ²)	13745	
Bodrumi	20618	
Destinimi	Banim	100%
	Afarizëm	0%
Banimi	Sipërfaqja totale (m ²)	44672
	Numri i vend parkimeve (1vendparkim / 1 apartament)	596
	Numri i banoreve	1787
Afarizmi	Sipërfaqja totale max. (m ²)	0
